



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **01.08.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve dhe kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit personal, e caktuar me vendimin nr. 20, datë 16.03.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj të pandehurit **Artur Gashi**, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, para ndryshimeve të bëra me Ligjin Nr. 43/2021”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Atalanta Zeqiraj, bazuar në nenet 112, 228, 229, 230, 237 dhe 248 të K.Pr.Penale, me vendimin **Nr. 96, datë 02.08.2024**, vendosi:

1. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “*arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj **të pandehurit Artur Gashi** caktuar me vendimin Nr. 20, datë 16.03.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për ekzekutimin e këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brënda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 02.08.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar